



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
FIER

Lagjja "29 Nëntori", Rruga "Todi Shkurta"

Nr. 636 i prot.

Fier, më 19.01.2024

Lënda: Mbyllje e procedurës së levizjes paralele

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
TIRANË

KËSHILLIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM FIER

Në zbatim të nenit 24 të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për levizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve nga Kancelari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim të procedurës "Për levizjen paralele", ju njoftojmë se për kategorinë e ulët drejtuese, për 1 (një) vend vakant për pozicionin "Shef Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier", nuk u kualifikua asnjë kandidat.

Deklarojmë të mbyllur këtë procedurë, e cila do të pasohet me procedurën tjetër atë të "Ngritjes në detyrë", për pozicionin Shef Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KANCELARE

Armela Divija

